

REPubliKA E KOSOVËS
REPubliKA KOSOVA


REPubliKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO
VI
Nr. Br. No. 2978 / 2024 - IN
Nr i Fa. Br. Str. No. Pg. 4
Data Datum Date 04.06.2024
Prishtinë / Pristina

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME
SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA - SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
--	-----------------------------------	--

Numëri i lëndës: Br. predmeta : Case Number:	C-IV-23-0688	Data: Datum: Date:	31.05.2024
Titulli i dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document name:	Datë/Datum/Dated:
Aktvendim			29.05.2024

Pala	Stranka	Party	Agjencia Kosovare e Privatizimit
Pranuar nga	Primio:	Received by	
Titulli	Zvanje:	Title	
Data	Datum:	Date	
Nënshkrimi	Potpis:	Signature	





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:268830

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05736249

C-IV- 23 – 0688

Parashtruesi i kërkesës : Autoriteti i Likuidimit (AL) për NSH „Ambulanca Veterinare – Prizren”, Agjencia kosovare e Privatizimit në Prishtinë, Rr. „Dritan Hoxha ” 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimi, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, bazuar në kërkesën e Autoritetit të Likuidimit për NSH „Ambulanca Veterinare”, më dt. 24 maj 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET Raporti Përfundimtar i AK për NSH „Ambulaca Veterinare” në Prizren.**
- II. Lejohet mbyllja e rastit të likuidimit ndaj kësaj NSH –je.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Më dt. 05.12.2023, parashtruesi i kërkesë ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, raportin përfundimtar të mbylljes së procesit të likuidimit për NSH „ Ambulanca Veterinare” në Prizren. Për këtë mbyllje është informuar edhe Bordi i Drejtoreve për AKP, më dt. 30 tetor 2023. Si rezultat i kësaj NSH, nuk ka asete të realizueshme si dhe duke pasur parasysh faktin se janë përmbushur të gjitha kërkesat kreditore të vlefshme në pajtim me nenin 40 të Ligjit nr. 04/L-034, dhe vërtetimit që nuk ka ankesa, të regjistruara në DHPGJS, AL i drejtohet DHPGJS për mbyllje zyrtare të likuidimit.

Ka bashkangjitur :

- Historikun e shkurtër dhe statusin e NSH „Ambulanca Veterinare”,
- Historiku i procesit të likuidimit,
- Vendimi për fillimin e procesit të likuidimit,



- Vendimi për emërimin anëtarëve të komisionit të AL, Vendimin e AL, PRN 115-0174, dt. 09.06.2015,
- Njoftimi për afatin e dorëzimit të kërkesave kreditore,
- Shpenzimin e procedurave të likuidimit,
- Lista e parashtruesve dhe datat e njoftimeve ,
- Lista e Vendimeve të AL-së të animuara dhe Vendimet përfundimtare të DHPGJS,
- Pasqyra financiare e llogaris bankare në likuidim,
- Lista e pranimeve dhe e pagesave, nga llogaria bankare në NSH në likuidim,
- Shkresa konfirmuese nga DHPGJS ,
- Raporti i Shpërndarjes,
- Lista e asetëve të pa shitura ,
- Lista e llogaritjeve të arkëtuara ,
- Ankesat në KSHL,
- Ankesat e dorëzuara në DHPGJS ndaj Vendimeve të AL-së,
- Pozicioni në para të gatshme në Likuidim,
- Historiku përmbledhës i likuidimit,
- Transaksionet e privatizimit dhe likuidimi,
- Vendimi për aprovimin e raportit të Autoriteti të Likuidimit,

Arsyetimi ligjor

Kërkesa e parashtruesit aprovohet

Sipas nenit 43, par1, të Shtojcës së ligjit 04/L - 034, për AKP-në, AL pas përfundimit të plotë të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit , apo pas mbylljes së rastit të likuidimit, ia parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve , para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti likuidimit .

Sipas nenit 44, para.1, të Shtojcës së Ligjit 04/L-034, për AKP, parasheh, që përveç rasteve të rregulluara në paragrafin 2 dhe 3, të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43, të kësaj Shtojce.

Autoriteti i Likuidimit ka dorëzuar raportin përfundimtar për aprovim përfshirë dokumentacionin e konstatuar si më lartë të rrethanat faktike.

Sipas historikut dhe statusit të NSH „Ambulanca Veterinare “ në Prizren është regjistruar në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, F/282/77, dt. 20.07.1977, si njësi e punës së bashkuar me seli në Prishtinë. , ndërsa më dt. 26.04.1995, kjo Ndërmarrje është transferuar nga OPB në „Ambulancën Veterinarie” në prizrenasi ndërmarrje në shërbim publik, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Shëndetit të Kafshëve .

Me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, më dt. 24.10.2010, është vendosur që NSH „Ambulanca Veterinare ” në procedurë të likuidimit , ndërsa më dt. 01 11. 2010, është themeluar Autoriteti i Likuidimit .



Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore ka qenë deri më dt. 11.01.2011, dhe të gjithë kreditorët potencial janë njoftuar përmes shpalljeve në gazeta të përditshme në gjuhën shqipe dhe serbe.

Autoriteti i likuidit, ka dorëzuar listën e kërkesave, sikundër edhe listën e aseteve të shitura që është përberë prej palujatshmerive zyre dhe tokë, lokal dhe tokë, të shitura më dt. 15.12.2006 dhe dt. 30.6.2014.

Në raportin, faqja 6 janë dhënë të dhënat nga shitja e aseteve gjatë privatizimit 168,500.00€, nga këto të ardhura janë ndarë shuma prej 20%, për punëtorët ose në shumën 42,125.00€, dhe 75 % nga të ardhurat që përfaqësojnë shumat e likuidimit 126,375.00€. Interesi i gjeneruar gjatë periudhës që është mbajtur në llogarinë bankare të privatizimit bankar të likuidimit 10,574.44€, të ardhurat nga shitja e aseteve gjatë likuidimit 10,949.00€, dhe interesi i gjenruar 40.31, të hyrat 147,938.75€.

Në raport raporte janë përfshirë edhe të dhënat tjera si tarifatat administrative, të Agjencisë 5%, rezervat për punëtorët nga shita e aseteve.

Sipas raportit si fonde të mbetura janë 32,235.95€.

Gjykata pas vlerësimit të kësaj gjendje faktike, vlerëson se Agjencia Kosovare e Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit për rastin konkret të likuidimit të NSH –së , i ka ndërmarr të gjitha verpimet dhe vendimet për mbyllje të likuidimit të NSH –së, andaj ka aprovuar Raportin Përfundimtar të NSH –së, dhe lejon mbylljes e rastit të likuidimit .

Me rastin e aprovimit të Raportit Përfundimtar, gjykata ka zbatuar dispozitën e nenit 44, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi lejohet të parashtrihet ankesë me shkrim, në afatin prej 15 ditëve Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar

